

VENDIM
Nr.24, datë 11.4.2007

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË
INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNA ME KONCESION**

Në mbështetje të nenit 26, pika 1, dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu IV, pika 1,a, të këtyre rregullave, dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.13, datë 5.3.2007 “Për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për metodën e përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

**METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TË UNIFIKUAR PËR ENERGJINË
ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË INSTALUAR
DERI NË 10 MW**

Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet) dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve.”.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është të përcaktojë një çmim unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e ERE-s për nxitjen e investimeve në burime të reja gjeneruese, me synim rritjen e transparencës, si dhe krijimin e kushteve të qëndrueshme, afatgjata, për pjesëmarrjen e sektorit privat në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

1. Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

1.1 “Çmimi unik” - çmimi i njëjtë i energjisë elektrike, i përcaktuar nga ERE sipas kësaj metodologjie për HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion.

1.2 “Çmimi mesatar i importit” - çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., në vitin paraardhës, që rezulton si raport i vlerës totale të fondit të shpenzuar për import me sasinë totale të energjisë elektrike të importuar në të njëjtin vit.

1.3 “Koeficienti i barabartë me 1.1” - bonusi që u jepet të licencuarve për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për reduktimin e humbjeve në masën 10% të sasisë së injektuar prej tyre në sistem në rrjet, si pasojë e lidhjes së këtyre burimeve

pranë ngarkesave në TM/TU.

2. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

2.1 Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet), akteve të tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

2.2 Energjia elektrike e prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, injektohet direkt me rrjetin TM/TU në shpërndarje. Në rastet kur e kërkon koncesionari, KESH sh.a. (subjekti i furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë) detyrohet të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish me kontratë afatgjatë, me qëllim rishitjeje të klientët tariforë që furnizohen në rrjetin e shpërndarjes.

2.3 Çmimi unik llogaritet duke iu referuar çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., në vitin paraardhës.

2.4 Çmimi unik, sipas kësaj metodologjie, do të rregullohet në funksion të ndryshimeve të çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike dhe normës mesatare të shkëmbimit euro/lekë të publikuar nga Banka e Shqipërisë për të njëjtin vit.

2.5 Çmimi unik llogaritet për të gjitha HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion sipas dispozitave të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”.

3. Formula e llogaritjes së çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion

3.1 Çmimi unik i energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, përcaktohet nga ERE në fillim të çdo viti.

3.2 Për të gjithë të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, që zgjedhin t’ia shesin energjinë elektrike të prodhuar prej tyre KESH sh.a.-së, çmimi unik llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$P_U = P_I * 1.1 * R_{EX}$$

ku:

P_U – çmimi unik i energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

P_I – çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike të realizuar nga KESH sh.a. në vitin paraardhës.

Koeficienti=1.1-bonusi që u jepet të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

R_{EX} – norma mesatare e shkëmbimit euro/lekë të publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin paraardhës.

4. Dispozita përfundimtare

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion sipas dispozitave të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave në zbatim të tij nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” u miratua nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike me vendimin nr.24, datë 11.4.2007.